

FTESË PËR OFERTË

Ref no: T-0012-08-2019

Banka ProCredit i fton të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për:

Furnizim me Terminale të Pikave të Shitjes (POS TERMINALE), për plotësimin e nevojave të Bankës ProCredit në Kosovë

Të interesuarit mund t'i kërkojnë dokumentet për aplikim prej datës **19 Gusht 2019** në e-mail adresën [kos.procurement\[at\]procredit-group.com](mailto:kos.procurement@procredit-group.com) .

Vërejtje:

- Banka ProCredit është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së, ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjne shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë mbrenda çmimit
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë tre muaj (90 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen në Euro (€).
- Ofertuesi duhet të paraqesë referenca të saj mbi shërbimet e ngjashme të ofruara më herët.
- Banka ProCredit mban të drejtën të kërkojë informata shtesë nga kompanitë e kualifikuara për ofertim.
- Kompania e përzgjedhur duhet të jetë e gatshme të ofrojë shërbimet në momentin që kërkohet nga banka ProCredit.
- Banka ProCredit ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe ti ftojë pjesëmarrësit për të sjellur sërish ofertat e tyre.

Data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar është **30 Gusht 2019** ora **15:00h**.

Oferta në zarf të mbyllur dhe e shënuar qartë **“Ofertë për POS terminale“** duhet të dorëzohet në Zyrën Qendrore të Bankës ProCredit (Rr. Xhorxh Bush Nr. 26, 10000 Prishtinë).

Çdo pyetje shtesë rreth kësaj ftese për ofertë mund ta adresoni në :

[kos.procurement\[at\]procredit-group.com](mailto:kos.procurement@procredit-group.com)